



## VENDIMI MBI PAPRANUESHMËRI

**Data e miratimit: 19 qershor 2019**

**Nr. i lëndës: 2018-03**

**E.V.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues  
Z. Petko PETROV, anëtar zëvendësues

Ndihmuar nga  
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Anesa është paraqitura në Panel më 10 gusht 2018 dhe është regjistruar më 16 gusht 2018.
2. Më 8 shkurt 2019, parashtrueses së ankesës iu ishte kërkuar të ofronte dokumentacion shtesë në mbështetje të ankesës së saj. Në veçanti, parashtrueses së ankesës iu ishte kërkuar të ofronte informacione lidhur me komunikimet që kishte me EULEX-in lidhur me ankesën e saj.
3. Më 12 shkurt 2019, ankuesja ka paraqitur dokumente shtesë në mbështetje të ankesës së saj.

## **II. PËRBËRJA E PANELIT**

4. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të tij të përhershëm, Paneli do të trajtoj këtë çështje vetëm me dy anëtarë, në përputhje me rregullën 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.
5. Ankuesja ka kërkuar që të mos zbulohet identiteti i saj. Duke e shqyrtuar këtë çështje, në veçanti natyrën e pretendimeve të bëra, Paneli është i bindur se kjo kërkesë në lidhje me duhet të miratohet.

## **III. FAKTET**

6. Siç janë parashtruar nga ankuesi, faktet mund të përmblidhen si më poshtë:
7. Ankuesja ka deklaruar se ajo me familjen e saj kishte ikur nga Mitrovicë në vitin 1999. Me sa duket, që nga ajo kohë prona e familjes në Mitrovicë është e usurpuar.
8. Në një datë të pasaktësuar, ankuesja ka paraqitur një kërkesë në Drejtorinë për Çështje Banesore dhe Pronësore (DÇBP) për kthyer në posedim pronën.
9. Në një datë të pasaktësuar, ankueses iu është dhënë në posedim prona. Me urdhër DS-300897, DÇBP-ja kishte urdhëruar dëbimin e banorëve të paligjshëm të pronës.
10. Pas dëbimit, me sa duket prona ishte zënë prapë. Banorët e ri të pronës me sa duket kishin paraqitur në DÇBP një kontratë të blerjes të datës 30 maj 2006.
11. Në një datë të pasaktësuar, ankuesja ka informuar DÇBP-në se kontrata e blerjes ishte e falsifikuar dhe ka kërkuar nga DÇPB-ja të urdhërojë dëbimin e banorëve të rinj. Më 10 tetor 2007, DÇBP-ja ka informuar me shkrim ankuesen se DÇBP-ja nuk ishte kompetente për trajtimin e atij rasti dhe e ka dërguar ankuesen në gjykatat e rregullta.
12. Më 8 dhjetor 2006, ankuesja ka paraqitur një padi në Gjykatën Themelore të Mitrovicës ndaj usurpuesve të pronës së saj dhe ka paraqitur një padi penale pranë Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ndaj usurpuesve të pronës së saj.
13. Në një datë të pasaktësuar, banorët e rinj e kanë shitur pronën një pale të tretë dhe kishte filluar ndërtimi i banesave.
14. Më 1 mars 2017, ankuesja ka paraqitur parashtrime shtesë lidhur me ankesën e saj penale. Me sa duket, kjo ankesë penale ende ishte në pritje pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
15. Më 25 gusht 2017, ankuesja ka informuar EULEX-in në lidhje me mungesën e progresit sa i përket ndjekjes penale dhe ka kërkuar ndihmën e Misionit.

16. Më 14 shtator 2017, EULEX-i ka informuar ankuesen se ankesa e saj nuk kishte hyrë në kuadër të mandatit të EULEX-it dhe se ajo duhet t'i drejtoi ankesat e saj tek autoritetet përkatëse të Kosovës.
17. Më 15 gusht 2018, ankuesja iu ka drejtuar EULEX-it përmes postës elektronike, duke kërkuar mbështetje për ndjekjen penale të individëve dhe institucioneve, të cilët pretendohet se kishin bërë komplot për uzurpimin e pronës së saj.
18. Më 20 shtator 2018, EULEX-i ka informuar ankuesen përmes postës elektronike se mandati i EULEX-it kishte ndryshuar në qershor të vitit 2018 dhe se më nuk ishte kompetent për të ushtruar hetime penale, ndjekjen penale dhe mbajtur seanca gjyqësore.

#### **IV. ANKESAT**

19. Ankuesja pohon se me dështimin e tyre për të vepruar siç duhet në përcjelljen e ankesave të saja, prokuroria, gjykatat dhe zyra kadastrale e Kosovës kanë shkelur të drejtat e saj të njeriut. Ankuesi kërkon nga EULEX-i që të fillojë ose ndërmarrë veprime ligjore ndaj institucioneve përkatëse të Kosovës dhe të ndjekë penalisht individët, të cilët dyshohet se kanë usurpuar pronën e saj. Në bazë të natyrës së ankesës duket se ankuesja pretendon në shkelje të të drejtave të saja sipas nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitave të ngjashme të përfshira në instrumente të tjera të zbatueshme ndërkombëtare.

#### **V. LIGJI**

20. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standarde minimale për mbrotjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
21. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të bazueshmërisë së saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me të, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29, në lidhje me rregullën 25 të rregullores së punës.
22. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
23. Paneli thekson që ankuesja nuk tregon e as ka paraqitur dëshmi për ndonjë dështim të fajshëm që i atribuohet EULEX-it. Nga ankesa është e qartë se EULEX-i nuk ishte në asnjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankeses. E as nuk

është vërtetuar se Misioni ishte kompetent mbi këtë çështje dhe se në mënyrë arbitrale kishte dështuar të përfshihej në këtë çështje.

24. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë fushës së mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si rrjedhojë jashtë kompetencës së Panelit, siç është formuluar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Gjithashtu ankesa është qartas e pabazuar.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzéri konstaton se kjo ankesë nuk hyn në kuadër të juridiksimonit të PShDNj-së në bazë të rregullës 29, 1(d) të rregullores së punës, kështu që është qartas e pabazuar sipas rregullës 29, 1(e) të rregullores së punës.

**SHPALL KËTË ANKESË TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

Guénaël Mettraux  
Kryesues



Petko Petkov  
Anëtar zëvendësues